



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:125098

Datë: 07.04.2022

Numri i dokumentit: 02893679

P.nr.806/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL në përbërje me gjyqtarin Shabi Idrizi si dhe me bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër te akuzuarve L.A nga Ferizaj Rr.”...” pn dhe V.G nga Ferizaj Rr.”...”, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020 duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020, për dhënien e urdhrin ndëshkimor vërejtje gjyqësore, gjykata me dt.01.02.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020 dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

1. **L.A** i lindur me datë ..., nga i ati M. dhe e ëma Sh., e gjinisë S., me vendbanim në Ferizaj Rr.”...”, me numër personal ... ka të kryer shkollën e mesme, me profesion menaxher në lokalit-kafiterin “C...”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

2. **V.G** i lindur me datë ..., nga i ati **L.** dhe e ëma **I.**, e gjinisë **M.**, me vendbanim në Ferizaj Rr.”...”, me numër personal ... ka të kryer shkollën e mesme, me profesion menaxher në lokal-in-kafiterin “C...”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Me datë 16 qershor 2020, rreth orës 16:50, në kafiterin “C..”, në rrugën “...” në Ferizaj, të mllefosur për shkak se i dëmtuari **A.K**, në gjendje të dehur, kishte shqetësuar myshterinjtë, të pandehurit në bashkëkryerje, me dashje që t’i shkaktojnë lëndime trupore, e godasin me grusht, në pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin e lartcekur për pasojë i njëjti pëson dërmishje dhe gërvishtje lëkurore të regjionit të faqes së majtë të fytyrës, të regjionit të anës së majtë të qafës dhe regjionit të supit të krahut të dorës së majtë të cilat si të tilla një nga një dhe së bashkë bëjnë lëndime të lehta trupore me pasojat të përkohshme të shëndetit.

- **me te cilën veprim në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 4, 31, 38,43, dhe 69, 73, të KPK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së, të pandehurve **L.A** dhe **V.G** ju shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurve ju bëhet me dije se kanë kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryejnë prapë vepër të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 /katërdhjetë/ Euro, si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020 i ka akuzuar të pandehurit L.A nga Ferizaj Rr.”...” pn dhe V.G nga Ferizaj Rr.”...””, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020 me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të pandehurit.

Duke u bazuar në aktin akuzues të prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1032/20 të datës 30.09.2020 dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata konstatoi se të akuzuarit L.A nga Ferizaj Rr.”...” pn dhe V.G nga Ferizaj Rr.”...” Me datë 16 qershor 2020, rreth orës 16:50, në kafiterin “C...”, në rrugën “12 Qershori” në Ferizaj, të mllëfosur për shkak se i dëmtuari A.K, në gjendje të dehur, kishte shqetësuar myshterinjtë, të pandehurit në bashkëkryerje, me dashje që t’i shkaktojnë lëndime trupore, e godasin me grushte, në pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin e lartëcekur për pasojë i njëjti pëson dërmishje dhe gërvishtje lëkurore të regjionit të faqes së majtë të fytyrës, të regjionit të anës së majtë të qafës dhe regjionit të supit të krahut të dorës së majtë të cilat si të tilla një nga një dhe së bashkë bëjnë lëndime të lehta trupore me pasojat të përkohshme të shëndetit.

Mbështetur në gjendjen faktike të vërtetuar edhe në bazë të provave të bashkangjitura, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 KPRK-së

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: raporti mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra

Emergjente në Ferizaj me numër protokollit 61 i datës 16.06.2020, akt ekspertiza mjeko ligjore në bazë të dokumenteve të çështjes nga Dr. Valon Hyseni e datës 24.09.2020, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë vërtetoi gjendjen si në dispozitiv të kësaj aktakuze.

Gjykata në përputhje me nenin 81 të KPRK-së, me rastin e caktimit të këtij sanksioni penale vërejtje gjyqësor ku të pandehurve i bëhet me dije se kanë kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryejnë prapë vepër të tillë, gjykata do të ju shqiptoj sanksion më të rëndë penal dhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së dhe se të pandehurit do të përmbahen që në të ardhmen mos të kryejnë vepra tjera penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e mori konform nenit 453 par. 1 të KPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në diapozitivit të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:125098, 01.02.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor është e lejuar ankesa në afat prej 8 (tetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.